

Date 29.04.2026

Procesverbal - Tipi i kontratës - Sherbim

**PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE
KRITEREVE PËR KUALIFIKIM**

(Ky procesverbal është për efekt publikimi bashkë me dokumentet e tenderit)

Objekti i procedurës: “Ristrukturim Web-it Zyrtar ”.

KODI PËRKATËS NË FJALORIN E PËRBASHKËT TË PROKURIMIT (CPV): Direct-access storage devices((dasd) -30233140-4 Servera 48820000-2 Servera rrjeti -48821000-9

Vlera e fondit limit: 1.400.000(një milion e katërqind mijë) Lekë, pa TVSH.

Në bazë të nenit 21, pika 2, të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, nenit 2, pika 2/c dhe nenit 78, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, e ndryshuar me VKM-në nr.714, datë 24.11.2021 autoriteti/enti kontraktor UKT sh.a ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si më poshtë:

I. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Kandidati/ofertuesi duhet të dorëzojë:

a. *Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 10*

b. *Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 3 përkatësisht në vlerën vlerën 28.000 (njetzet e tete mijë) leke (e zbatueshme në rastin e procedurave të prokurimit me një vlerë më të lartë se sa prokurimi me vlerë të vogël)*

Argumentimi: Kërkesat e mësipërme bazohen në nenet 76, 82 dhe 83 të LPP, nenit 26, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” e ndryshuar

2. Kandidati/Ofertuesi duhet të dorëzojë:

2.2 Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

2.2.1. Për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin vërtetim për xhiron vjetore për vitet financiare (2023, 2024, 2025) ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë jo më e vogël se 40% të fondit limit.

Kërkesa për plotësimin e kapaciteteve financiare konsiderohet e përmbushur nëse operatorët ekonomikë arrijnë vlerën e xhiros minimale, në të paktën një vit të periudhës së kërkuar nga autoriteti/enti kontraktor.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në vlerën e fondit limit të kësaj procedure, si dhe bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenin 43, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” e ndryshuar.

Përcaktimi i vlerës së kërkuar argumentohet si më poshtë:

2.2.2 Operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë pasqyrat financiare vjetore (bilancet) gjatë 3(tre) viteve të fundit (2023, 2024, 2025) të çertifikuar nga organet tatimore. Në rast se operatori ekonomik është në kushtet e përcaktimeve të nenit 41, të ligjit nr.10091, datë 05.03.2009, atëherë bilancet duhet të shoqërohen edhe me akt-ekspertizën e ekspertit kontabël të autorizuar. Kjo kërkesë konsiderohet e përmbushur nëse në dy bilance të njëpasnjëshme, nuk ka raport negativ ndërmjet aktivitetit dhe pasivit.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenin 43, pika 4, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” dhe nenin 19, pika 2, të VKM Nr. 498, datë 1.8.2024 për disa shtesa dhe ndryshime në vendimin nr. 285, datë 19.5.2021, të këshillit të ministrave, “PËR MIRATIMIN E RREGULLAVE TË PROKURIMIT PUBLIK”, të ndryshuar.

2.2.3 Operatori ekonomik duhet të paraqesë vërtetim për shlyerjen e taksave vendore të parashikuara nga Pushteti Vendor për vitin 2026 të përfshihet kësti për periudhën përkatëse të maturuar sipas ligjit nr.9632 datë 30.10.2006)“Për sistemin e taksave vendore” i ndryshuar; **(lidhur me afatet e kryerjes së pagesave të caktuara nga njësitë e vetëqeverisjes vendore për vitin 2026).**

(Në çdo rast AK ka të drejtë të kryejë verifikimet e nevojshme mbi vërtetësinë e informacionit të deklaruar nga operatorit ekonomik ose ti kërkojë operatorit ekonomik sqarime dhe dokumente mbështetëse për këto sqarime). Në rastet e bashkimit të operatorëve ekonomikë, çdo anëtar i grupit duhet të dorëzojë vërtetimin lëshuar nga Autoriteti përkatës në të cilën është regjistruar sipas QKB.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenit 43, pika 6, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” e ndryshuar dhe në ligjin nr.9632, datë 30.10.2006 “Për Sistemin e Taksave Vendore” i ndryshuar, në ligjin nr.9920 datë 19.05.2008 “Per procedurat tatimore” i ndryshuar, neni 4, pika 2 d).

Për përmbushjen e këtij kriteri, operatorët ekonomikë duhet të vetëdeklarojnë se ka paguar detyrimet e taksave vendore për vitin 2026 sipas kësteve të parashikuara në ligjin nr.9632, datë 30.10.2006 si dhe vendimeve respektive të Këshillave Bashkiakë në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit të DST-së objekt prokurimi.

Në cdo rast AK ka të drejtë të kryejë verifikimet e nevojshme mbi vërtetësinë e informacionit të deklaruar nga operatori ekonomik ose ti kërkojë operatorit ekonomik sqarime dhe dokumente mbështetëse për këto sqarime.

2.3 Kapaciteti teknik:

2.3.1. Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për furnizimet e mëparshme të ngjashme, të kryera gjatë tre viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës, në një vlerë jo më të vogël se 20 % të vlerës së fondit të limit

Për të vërtetuar përvojën e mëparshme të ngjashme, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin dëshmitë e mëposhtme:

- a) për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin publik, operatori ekonomik duhet të paraqesë vërtetime të lëshuara nga një ent publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës dhe fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruar në organet tatimore ku shënohen datat, shumat dhe sasi të shërbimeve të furnizuara, ose
- b) për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin privat, operatori ekonomik duhet të paraqesë fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruar në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe shërbimet e furnizuara

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe në nenin 55, pika 4/b), të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” e ndryshuar.

Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën, prandaj është kërkuar që furnizimet e mëparshme të ngjashme të jenë në vlerën jo më pak se 20 % të vlerës së fondit limit, që është brenda vlerës kufirit të përcaktuar në nenin e sipërcituar.

2.4 Operatori ekonomik ofertues duhet të jetë i Certifikuar si kompani sipas standardeve ISO të lëshuara nga organizmat e vlerësimit të konformitetit të cilat janë të akredituara nga DPA ose nga organizmat ndërkombëtare akreditues të njohur nga Republika e Shqipërisë, konkretisht:

- a) **ISO 9001:2015 (ose ekuivalente)** (e vlefshme). (Në rastet e bashkimit të operatorëve ekonomik, çdo anëtar i grupit duhet të paraqesë Çertifikatën ISO sipas zerave që do të marre persiper sipas akt-marreveshjes).

- b) **ISO 27001:2022** ose ekuivalente, për Sigurinë e Informacionit (e vlefshme);). (Në rastet e bashkimit të operatorëve ekonomik, çdo anëtar i grupit duhet të paraqesë Çertifikatën ISO sipas zerave që do të marre persiper sipas akt-marreveshjes).

Argumentimi: Ky kriter u vendosën në përputhje me parashikimin e nenit 36 dhe nenit 77, të Ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, si dhe nenit 44, të VKM-se Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, ne baze të Njoftimit të Agjencisë së Prokurimit Publik Nr. 2502 Prot., date 09.04.2021, si dhe Ligjit Nr. 116/2014 “Për akreditimin e organeve të vlerësimit të konformitetit në Republikën e Shqipërisë”, ku percaktohet se këto Certifikata duhet të jenë të lëshuara nga organizma certifikues të akredituar, me qëllim që enti prokurues të krijojë sigurinë që operatorët ekonomik ofertues i kanë kapacitetet teknike lidhur aftësinë e tyre për të kryer shërbimin objekt kontrate. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë se disponojnë licencat profesionale që parashikohen nga legjislacioni në fuqi për kryerjen e shërbimeve, objekt i kontratës, të lëshuara nga autoritetet kompetente kompetente.

Standarti i cilesise ISO 9001 (ose versione me te voneshme aktive) : eshte sot referimi i njohur ne nivel nderkombetar, per certifikimin e sistemit te menaxhimit te cilesise te kompanive te te gjithe sektoreve dhe te gjithe permasave. Ky kriter kerkohet nga AK me qellim per te vertetuar cilësinë e shërbimit dhe të garantojë realizimin në kohë, me sukses dhe me cilësi sipas standardeve ndërkombëtare të objektit të kontratës.

ISO 27001 (ose versione me te voneshme aktive): Ky standard është i nevojshëm për krijimin, zbatimin, mirëmbajtjen dhe përmirësimin e vazhdueshëm të një sistemi të menaxhimit të sigurisë së informacionit. Ky standard përfshinë kërkesat për vlerësimin dhe trajtimin e rreziqeve të sigurisë së informacionit të përshtatura për nevojat e organizatës, me qëllim që informacioni të mbetet i sigurtë dhe të mos çenohet siguria e sistemeve të saj nga sulmet kibernetike.

AK duhet te marre çdo mase te nevojshme per parandalimin dhe mos cenimin e veprimtarise se saj, ku per shkak te moscertifikimit te duhur te kontraktoreve, AK duhet te pezulloje ose te vonoje veprimtarine e saj, duke shkaktuar nje dem te madh ne operimin e sistemit te burses energjitike shqiptare dhe ate te rajonit, ku eshte edhe objekti i saj kryesor.

2.6 Operatori ekonomik duhet të ketë personel teknik prej 10 personash prej të paktën tre muajt e fundit nga data e publikimit të njoftimit të kontratës, të diplomuar në degët e Inxhinierisë Elektronike, Informatike, etj. që do të angazhohen në implementimin e projektit, duke pasur njohuri të kombinuar sipas kërkesave të mëposhtme:

- 1(nje) punonjes te jete e certifikuar per marketing Dixhital.
- 1(nje) punonjes te jete diplomuar, per shkenca kompjuterike.
- 1(nje) punonjes te jete Inxhiner Softuerik.
- 1(nje) punonjes te jete diplomuar Teknologji Informacioni dhe komunikimi.

➤ **Shënim:** OE duhet të mbajnë në konsideratë përcaktimet ligjore, referuar Nenit 26, pika 1, të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, ku parashikohet se, “Bashkë me dorëzimin e kërkesave për pjesëmarrje ose të ofertave, autoriteti/enti kontraktor pranon si provë paraprake, në vend të disa vërtetimeve të lëshuara nga autoritetet publike ose palë të treta, formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas përcaktimit në nenin 82, të LPP-së, dhe në këto rregulla”, si dhe përcaktimet e pikës 6, të këtij neni, në lidhje me momentin e paraqitjes së dokumentacionit dëshmuës për kërkesat që përfshihen në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, ku parashikohet që, “Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar, i pari dorëzimin e dokumenteve provuese të parashikuara në shkronjat “a”, “b”, “d”, “dh”, “e”, “h”, “i”, “j” të pikës 2 të këtij neni, si dhe dokumentet e tjera shoqëruese të ofertës, të dorëzuara në rrugë elektronike. Këto dokumente duhet të paraqiten në origjinal ose në kopje të njësuara me origjinalin.”.

Për të dëshmuar përmbushjen e këtij kriteri, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin për punonjësit e sipërcituar dokumentacionin e mëposhtëm:

- Operatorët ekonomik duhet të dorëzojnë formularët (E-SIG 025/a) të deklaruar të listëpagesave për tre muajt e fundit. Dëshmitë / Çertifikata kualifikimi nga institucione përkatëse.,diplome dhe kontrate pune Në rastin kur këta punonjës kanë një titull tjetër në pozicionin e punës, duhet të dorëzojnë diplomat përkatëse.

Argumentimi: Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 41, pika 4/ b), të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë stafin, persnelin e nevojshëm të kualifikuar për realizimin me sukses të kontratës.

Argumentim teknik :

Kriteri i mësipërm është vendosur në funksion të garantimit të kapaciteteve teknike dhe profesionale të operatorit ekonomik për realizimin me sukses të kontratës, duke siguruar që implementimi i projektit të kryhet nga staf i kualifikuar dhe me eksperiencë në fushat përkatëse të teknologjisë së informacionit dhe komunikimit.

Ristrukturimi i një web-i zyrtar përfshin jo vetëm ndërtimin apo përmirësimin vizual të platformës, por edhe zhvillimin e arkitekturës së sistemit, menaxhimin e databazës, sigurinë kibernetike, optimizimin e performancës, aksesueshmërinë, integrimet me sisteme të tjera dhe promovimin institucional në mjedisin digjital. Për këtë arsye, kërkohet një ekip multidisiplinar me njohuri të kombinuara, si më poshtë:

- **Punonjësi i certifikuar në Marketing Digjital** është i nevojshëm për optimizimin e prezencës online të institucionit, përmirësimin e aksesueshmërisë së informacionit publik, SEO (Search Engine Optimization), analizimin e trafikut dhe strukturimin e përmbajtjes sipas standardeve moderne të komunikimit digjital institucional.
- **Punonjësi i diplomuar në Shkenca Kompjuterike** garanton njohuritë bazë dhe të avancuara mbi programimin, strukturat e sistemeve informatike, databazat dhe implementimin teknik të funksionaliteteve të web-it.
- **Inxhinieri Softuerik** është i domosdoshëm për projektimin, zhvillimin, testimin dhe mirëmbajtjen e komponentëve software të platformës, duke garantuar funksionalitet, shkallëzueshmëri, siguri dhe përputhshmëri me standardet teknike.
- **Punonjësi i diplomuar në Teknologji Informacioni dhe Komunikimi (TIK)** nevojitet për administrimin e infrastrukturës teknologjike, integrimin e sistemeve, menaxhimin e komunikimit të të dhënave dhe garantimin e funksionimit të qëndrueshëm të platformës online.

Kërkesa që operatori ekonomik të disponojë të paktën 10 persona staf teknik për minimumi 3 muajt e fundit lidhet drejtpërdrejt me nevojën për të provuar kapacitetet reale njerëzore dhe vazhdimësinë operacionale të operatorit ekonomik, duke shmangur angazhimin formal ose të përkohshëm të stafit vetëm për efekt procedure. Ky numër konsiderohet proporcional me natyrën dhe kompleksitetin e projektit, pasi restrukturimi i web-it zyrtar kërkon njëkohësisht analizë, dizajn, zhvillim, testim, migrim të dhënash, trajnim dhe suport teknik

Argumentimi i specifikimeve teknike

Specifikimet teknike të hartuara për këtë procedurë janë përcaktuar në funksion të natyrës, kompleksitetit dhe rëndësisë së projektit për krijimin e një platforme web moderne, të sigurt dhe funksionale, e cila do të shërbejë si kanal zyrtar komunikimi ndërmjet institucionit dhe publikut.

Këto specifikime synojnë garantimin e cilësisë së zhvillimit, sigurisë së informacionit, performancës së sistemit dhe mundësisë së zgjerimit në të ardhmen, duke respektuar standardet bashkëkohore të zhvillimit software dhe administrimit të platformave institucionale.

Në mënyrë të detajuar, argumentimi teknik paraqitet si më poshtë:

- **Kërkesat për analizë, projektim dhe zhvillim të platformës** janë të nevojshme për të siguruar që website-i të ndërtohet mbi baza funksionale dhe teknike të qarta, duke përfshirë analizën e kërkesave, dizajnin UX/UI, zhvillimin frontend/backend, testimin dhe implementimin final. Këto elemente janë standarde të domosdoshme në çdo projekt profesional të zhvillimit web.
- **Përcaktimi i moduleve funksionale**, si faqet informative, lajmet dhe njoftimet, moduli i kërkesave dhe ankesave, paneli administrativ dhe integrimet me sisteme të tjera, është i lidhur drejtpërdrejt me nevojat operacionale të institucionit për ofrimin e shërbimeve online dhe rritjen e transparencës ndaj qytetarëve.
- **Teknologjitë e propozuara** si HTML5, CSS3, Tailwind CSS, React/Next.js, Laravel ose Node.js, REST API/GraphQL dhe PostgreSQL/MySQL janë zgjedhur pasi përfaqësojnë standarde moderne të industrisë, të cilat garantojnë:
 - performancë të lartë;
 - siguri;
 - mirëmbajtje të lehtë;
 - shkallëzueshmëri;
 - kompatibilitet me pajisje dhe sisteme të ndryshme.
- **Kërkesat për infrastrukturën dhe hostimin** janë të domosdoshme për garantimin e disponueshmërisë së sistemit, sigurisë së të dhënave dhe performancës optimale. Përdorimi i Cloud VPS/Cloud Provider, SSL, backup-eve automatike dhe CDN mundëson funksionim të qëndrueshëm dhe mbrojtje ndaj humbjes së të dhënave apo ndërprerjeve të shërbimit.
- **Specifikimet e sigurisë** janë vendosur për të garantuar mbrojtjen e sistemit dhe të dhënave nga akseset e paautorizuara dhe sulmet kibernetike. Implementimi i kontrollit të aksesit sipas roleve, firewall-eve, mbrojtjes ndaj SQL Injection/XSS, CAPTCHA dhe audit logs përbën praktikë standarde në zhvillimin e platformave institucionale.
- **Kërkesat për SEO dhe aksesueshmëri** janë të nevojshme për të siguruar që website-i të jetë lehtësisht i aksesueshëm nga qytetarët dhe i indeksueshëm nga motorët e kërkimit. Përputhshmëria me standardin WCAG 2.1 garanton akses për përdoruesit me aftësi të kufizuara, në përputhje me praktikatat moderne të aksesueshmërisë digjitale.
- **Struktura logjike e databazës** është përcaktuar në mënyrë modulare për të garantuar integritetin, organizimin dhe administrimin efikas të të dhënave, duke mundësuar zgjerime dhe integritet të ardhshme të sistemit.
- **Paneli i administrimit** është kërkuar për të siguruar autonomi dhe efikasitet në menaxhimin e përmbajtjes, përdoruesve, dokumenteve dhe statistikave nga stafi i institucionit pa nevojën e ndërhyrjeve teknike të vazhdueshme.
- **Standardet UX/UI** janë të domosdoshme për të garantuar një eksperiencë përdorimi intuitive, moderne dhe të aksesueshme në të gjitha pajisjet, duke respektuar njëkohësisht identitetin vizual të institucionit.
- **Arkitektura e sistemit e ndarë në shtresa** është zgjedhur për të garantuar fleksibilitet, siguri, mirëmbajtje të lehtë dhe mundësi integrimi me sisteme të tjera ekzistuese ose të ardhshme.

- **Kërkesat për performancën** si caching, lazy loading, optimizimi i imazheve dhe minification janë të nevojshme për të siguruar kohë të shpejtë ngarkimi dhe performancë optimale të platformës.
- **Mirëmbajtja dhe mbështetja teknike** janë kërkuar për të garantuar funksionimin e qëndrueshëm të sistemit pas implementimit, përmes monitorimit, përditësimeve të sigurisë, testeve periodike dhe reagimit ndaj incidenteve teknike.

Njesia e Prokurimit: